



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.5

19 janar

2007

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.3, datë 10.1.2007	Për nxitjen e zhvillimit të vreshtarisë, pemëtarisë dhe ullirit.....	75
Vendim i KM nr.4, datë 5.1.2007	Për miratimin e amendamentit nr.1 të marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe ALBPETROL-it, bashkësisë ekonomike të naftës dhe gazit (sot “ALBPETROL” sh.a.).....	75
Vendim i KM nr.5, datë 10.1.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.722, datë 25.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe masën e përfitimit të pagesës së papunësisë nga bashkëshorti/ja e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”	76
Vendim i KM nr.9, datë 10.1.2007	Për një shtesë në vendimin nr.67, datë 22.1.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e uniformës dhe të shenjave dalluese të Gardës së Republikës së Shqipërisë”...	77
Vendim i KM nr.11, datë 10.1.2007	Për kalimin në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit të sipërfaqes së truallit në kthesën e Kamzës, Tiranë.....	77

Vendim i KM nr.15, datë 10.1.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.646, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike, të projektimit dhe të zbatimit, në fushat e industrisë dhe të energjetikës, të cilat duhet të marrin statusin “Rregulla teknike”, të detyrueshme për zbatim”, të ndryshuar.....	78
Vendim i KM nr.16, datë 10.1.2007	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.704, datë 16.11.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kriterëve të përfaqësimit, të përzgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të anëtarëve dhe rregullat e funksionimit të Këshillit të Statistikave”, të ndryshuar.....	79
Udhëzim i MB nr.130, datë 18.1.2007	Për procedurat e rishikimit të listave paraprake dhe shpallja e listës përfundimtare të zgjedhësve “Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 18 shkurt 2007”.....	81

VENDIM
Nr.3, datë 10.1.2007

PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT TË VRESHTARISË, PEMËTARISË DHE ULLIRIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për vitin 2007, zëri “Transfertë në buxhetet familjare”, të përdoren për nxitjen e zhvillimit të vreshtarisë, pemëtarisë dhe ullirit, si më poshtë vijon:

- Për fermerë individualë, që ngrenë vreshta ose pemëtore të reja, me sipërfaqe jo më pak se 3 dynym;

- Për fermerë individualë, që ngrenë ullishte të reja, me sipërfaqe jo më pak se 2 dynym.

2. Masa e përfitimit të jetë, si më poshtë vijon:

- Për ngritje vreshti, 500 000 lekë/ha;

- Për ngritje pemëtoreje, 350 000 lekë/ha;

- Për ngritje ullishteje, 350 000 lekë/ha.

3. Kriteret dhe procedurat e dhënies së mbështetjes përcaktohen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.4, datë 5.1.2007

PËR MIRATIMIN E AMENDAMENTIT NR.1 TË MARRËVESHJES SË LIDHUR MË 26.7.1993, NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIISË, BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKËS (SOT MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS) DHE ALBPETROL-IT, BASHKËSISË EKONOMIKE TË NAFTËS DHE GAZIT (SOT “ALBPETROL” SHA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e amendamentit nr.1 të marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës) dhe Alpetrol-it, bashkësisë ekonomike të naftës dhe gazit (sot “Albpetrol”, sh.a.), sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AMENDAMENT NR.1

I MARRËVESHJES SË LIDHUR MË DATË 26.7.1993 MIDIS MINISTRISË SË INDUSTRIJË,
BURIMEVE MINERARE DHE ENERGJETIKE (SOT MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS) DHE ALBPETROL-IT, BASHKËSISË EKONOMIKE TË NAFTËS DHE GAZIT
(SOT “ALBPETROL” SHA)”

Me objekt: Autorizim për kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

Në listën “B” të Marrëveshjes, bëhet ky reformulim:

OBJEKTET E KËRKIMIT

Delvinë

X1 = 44 39 000¹

Y1 = 44 14 600

X2 = 44 21 900

Y2 = 44 35 600

X3 = 44 14 600

Y3 = 44 27 500

X4 = 44 25 500

Y4 = 44 14 500

Në emër të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

Zëvendësministri

Gjergj Bojaxhi

Në emër të “Albpetrol” sh.a.:

Drejtori i Përgjithshëm

Ilia Fili

Tiranë më 16.8.2006

VENDIM

Nr.5, datë 10.1.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.722, DATË 25.10.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET DHE MASËN E PËRFITIMIT TË PAGESËS SË PAPUNËSISË
NGA BASHKËSHORTI/JA E PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETITIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 38, pikat 1 e 2, e 55, pika 2, të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, dhe të pikës 2 të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 3 e vendimit nr.722, datë 25.10.2006 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Masa e trajtimit financiar të jetë, si më poshtë vijon:

a) 100 për qind e pagës minimale mujore, në shkallë vendi, e miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune nga 1 deri në 10 vjet.

b) 120 për qind e pagës minimale mujore, në shkallë vendi, e miratuar nga Këshilli i Ministrave, kur bashkëshorti/ja e papunë ka vjetërsi pune mbi 10 vjet.

Trajtimi i veçantë financiar ndryshon, sa herë ndryshon paga minimale mujore në shkallë vendi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16.5.2005.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

¹ Shënim. Koordinatat e objekteve janë ortogonale.

VENDIM
Nr.9, datë 10.1.2007

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.67, DATË 22.1.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E UNIFORMËS DHE TË SHENJAVE DALLUESE TË GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18 të ligjit nr.8869, datë 22.5.2002 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.67, datë 22.1.2004 të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1 shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje

“1/1. Ministri i Brendshëm miraton:

- a) Rregulloren e uniformës së punonjësit të Gardës;
- b) Normat e materialeve të veshmbathjes, që janë në inventar të njësive, nënjësive dhe grupeve;
- c) Normat e furnizimit me veshmbathje të gardistëve, nënoficerëve dhe oficerëve të Gardës;
- ç) Normat e furnizimit me veshje civile të punonjësve të Gardës ose të konvertimit të tyre në vlerë në lekë;
- d) Normat e materialeve të konsumit dhe të mirëmbajtjes;
- dh) Normat e pajisjeve për qentë;
- e) Normat e veshmbathjes së posaçme dhe të rrobave të punës për profesionet e ndryshme falas;
- ë) Zëvendësimet e materialeve të veshmbathjes brenda vlerës së normës”.

2. Emërtimi “Ministri i Rendit Publik” zëvendësohet me “Ministri i Brendshëm”.

3. Vendimi nr.503, datë 8.11.1999 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normës 3/1 të veshmbathjes për ushtarët e shërbimit të detyrueshëm të Gardës së Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.11, datë 10.1.2007

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT TË SIPËRFAQES SË TRUALLIT NË
KTHESËN E KAMZËS, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja e truallit në kthesën e Kamzës, Tiranë, prej 85 000 m² në parcelën nr.68, në zonën kadastrale 2679, në fshatin Mëzes, e regjistruar në volum 4, faqe 161, me pronar shtet, të kalojë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për administrimin e këtij trualli dhe për mbarëvajtjen e marrëveshjes me shoqërinë malajziane “PSC”, për projektin e strehimit.

3. Ngarkohen Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministri i

Brendshëm dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.15, datë 10.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.646, DATË 12.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE DHE TË KUSHTEVE TEKNIKE, TË PROJEKTIMIT DHE TË ZBATIMIT, NË FUSHAT E INDUSTRISË DHE TË ENERGETIKËS, TË CILAT DUHET TË MARRIN STATUSIN “RREGULLA TEKNIKE”, TË DETYRUESHME PËR ZBATIM”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.8464, datë 11.3.1999 “Për standardizimin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.646, datë 12.12.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat, sipas lidhjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja

VAZHDIM I LIDHJES NR.1 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.646, DATË 12.12.2002, I NDRYSHUAR

Lista e standardeve të detyrueshme aktualisht në fuqi, që miratohen në “Rregulla teknike” të detyrueshme për zbatim:

Kreu 1: Naftë, gaz dhe produkte nafte;

Pika 2 ndryshohet, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Kërkesat themelore të standardeve shqiptare ose standardeve të barazvlefshme me to
2	Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial – G.L.N.(Mishelë) – Kërkesat dhe metodat e provës.	SSH EN 589: 2004/AC -Niveli i avujve të presuar, min.150 kPa, në temperaturën sipas grupeve A, B,C, D. -Përmbajtja e përgjithshme e dieneve (duke përfshirë 1.3 butadiene) -Sulfuri i hidrogjenit (H ₂ S) -Mbetja pas avullimit

Pas pikës 23 shtohet pika 23/1, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Kërkesat themelore të standardeve shqiptare ose standardeve të barazvlefshme me to
23/1	Produkte naftë – Lëndë djegëse (klasa F) – gaze të lëngët nga nafta propan dhe butan – Specifikimet.	SSH ISO 9162: 1989 -Për propanin: -C ₄ , %(molar), max -Për butanin: -Hydrokarburet C ₅ , % (molar), max. -Për propanin dhe butanin: -Dienet, % (molar), max. -Sulfuri i hidrogjenit (H ₂ S).

VENDIM
Nr.16, datë 10.1.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.704, DATË 16.11.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË PËRFAQËSIMIT TË PËRZGJEDHJES, EMËRIMIT DHE SHKARKIMIT TË ANËTARËVE, DHE RREGULLAT E FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TË STATISTIKAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.704, datë 16.11.2005 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 10, të bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Rendi i ditës i mbledhjes së zakonshme caktohet nga kryetari i Këshillit të Statistikave në këshillim me Drejtorin e Përgjithshëm të INSTAT-it. Në rendin e ditës përfshihen drejtpërdrejt çështjet, për të cilat është rënë dakord në mbledhjet pararendëse, dhe projektpropozimet e paraqitura për shqyrtim nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it. Kryetari i këshillit vendos të përfshijë në rendin e ditës çdo çështje tjetër, sipas kërkesës me shkrim të të paktën 3 anëtarëve përfaqësues të agjencive statistikore. Kërkesa me shkrim është e vlefshme, kur mban numrin e protokollit të agjencive përkatëse dhe vulat respektive.

Në mungesë të kryetarit të këshillit, zëvendëskryetari ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, sipas këtij vendimi, ka detyrimin ligjor të përgatisë projektaktet dhe relacionet shoqëruese vetëm për çështjet, që përfshihen drejtpërdrejt në rendin e ditës. Për çështje të tjera, përgatitja e projektakteve dhe e relacioneve kryhet nga propozuesit. Në fund të mbledhjes anëtarët bien dakord për datën e mbledhjes së ardhshme të Këshillit të Statistikave. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes. Rendi i ditës caktohet jo më vonë se 12 ditë kalendarike nga dita e thirrjes së mbledhjes së Këshillit të Statistikave. Kopja e njoftimit të rendit të ditës, e nënshkruar nga kryetari/zëvendëskryetari i Këshillit të Statistikave, u shpërndahet, menjëherë, anëtarëve.

Në raste të veçanta, vetëm për çështje urgjente, të përcaktuara në njërin nga shkronjat “a” deri “dh” të nenit 11 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, kryetari i Këshillit të Statistikave ose, në mungesë të tij, zëvendëskryetari, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it, cakton brenda 48 orësh nga paraqitja e kërkesës mbledhjen. Mbledhja thirret brenda 5 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës.”.

b) Pas shkronjes “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Rendi i ditës i mbledhjes së jashtëzakonshme caktohet me kërkesën e 1/3 së anëtarëve. Kërkesit depozitohen kërkesën me shkrim pranë Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it, i cili i përcjell,

menjëherë, me shkrim, kryetari të Këshillit të Statistikave kërkesën për mbledhje të jashtëzakonshme. Kur sipas gjykimit të Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it, këtij rendi mund t'i shtohen edhe çështje të tjera të papërmendura, krahas kërkesës ai i dërgon kryetari edhe propozimin për rendin shtesë. Kryetari, brenda 5 ditëve pune nga marrja e propozimit, thërret mbledhjen e jashtëzakonshme të këshillit.”.

2. Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Procedura e zhvillimit të mbledhjes dhe rregulla të tjera

a) Mbledhja e Këshillit të Statistikave drejtohet nga kryetari. Kur ai mungon në mbledhje, ajo drejtohet nga zëvendëskryetari dhe, në mungesë të tij, drejtohet nga anëtari me vjetërsi më të madhe në këtë këshill, i pranishëm. Në rast se ka disa anëtarë, që kanë shërbyer për të njëjtën periudhë kohe, mbledhja drejtohet nga anëtari, me moshë më të madhe, i pranishëm.

b) Mbledhja e Këshillit të Statistikave deklarohet e hapur pasi drejtuesi i saj verifikon, paraprakisht, praninë në mbledhje të quorumit të nevojshëm të anëtarëve. Në mbledhje merr pjesë, pa të drejtë vote, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it dhe, në mungesë të tij, për shkaqe ligjore, një punonjës tjetër i nivelit drejtues, i autorizuar shprehimisht prej tij. Për shqyrtimin e çështjeve teknike gjatë mbledhjes, Drejtori i Përgjithshëm mund të asistohet, sipas vlerësimit të tij, edhe nga një staf teknik i INSTAT-it, i cili jep shpjegime apo saktësime për çështjen, sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm.

Çështjet e rendit të ditës shqyrtohen sipas renditjes, me përjashtim të rasteve kur anëtarët, me votim të hapur, vendosin ndryshe. Për çdo çështje që diskutohet në mbledhjen e Këshillit të Statistikave, vendoset me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Procedura e votimit është e hapur. Propozimi votohet vetëm pro apo kundër, abstenimi nuk lejohet. Në rast të barazimit të votave, projektakti vlerësohet i rrëzuar.

Kur anëtari i Këshillit të Statistikave ka interes privat në çështjen në shqyrtim, që përbën shkak ligjor për konflikt interesash, sipas legjislacionit në fuqi, ai është i detyruar të deklarojë me shkrim interesat e veta dhe mospjesëmarrjen në mbledhje e në votim. Në këtë rast preket quorumi i i kërkuar, çështja shtyhet për mbledhjen më të afërt.

Drejtuasi i mbledhjes për një ose disa çështje të rendit të ditës, që nuk arrijnë të shqyrtohen në mbledhjen e radhës, hedh në votim vazhdimin e mbledhjes në një ditë tjetër ose kalimin e këtyre çështjeve në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme. Për çështjet, që lidhen me përgjegjësitë e përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr.9180, datë 5.2.2004 “Për statistikat zyrtare”, mbledhja e ardhshme caktohet brenda 5 ditëve kalendarike.

Në fund të mbledhjes, anëtarët e pranishëm kanë të drejtë të propozojnë çështje të tjera shtesë, për t’u përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes së ardhshme. Propozimi votohet dhe, kur merr shumicën e votave, përfshihet drejtpërdrejt në rendin e ditës së mbledhjes pasardhëse. Përjashtim nga rregulli bëjnë vetëm propozimet për projektvendime me karakter individual. Shqyrtimi i tyre kryhet në të njëjtën mbledhje.

c) Për çdo mbledhje të Këshillit të Statistikave mbahet procesverbal, i cili zbardhet nga sekretariati i këshillit, brenda pesë ditëve. Elementet përbërëse të procesverbalit të mbledhjes përcaktohen në shkronjën “ç”, të kësaj pike. Procesverbali miratohet dhe nënshkruhet rregullisht nga të gjithë pjesëmarrësit para mbledhjes pasardhëse. Për çdo projektpropozim të votuar hartohen vendimet e marra, të cilat nënshkruhen nga kryetari i këshillit ose nga drejtuesi i mbledhjes, sipas shkronjës “a” të pikës 11.

Procesverbalet, vendimet e Këshillit të Statistikave dhe relacionet shoqëruese ruhen dhe administrohen në dosje sipas rregullores për arkivat. Kopje të tyre mund t’i jepen çdo anëtari, që i kërkon.

ç) Në procesverbal vendosen numri dhe lloji i mbledhjes: “e zakonshme”, “e zakonshme urgjente” apo “e jashtëzakonshme”, data, koha e fillimit dhe e mbylljes, emri i drejtuesit dhe i sekretarit të mbledhjes, emrat e anëtarëve të pranishëm, emrat e anëtarëve që mungojnë dhe shkaqet e mungesës, rendi i ditës, mendimet për çdo projekt të paraqitur, rezultatet e votimit, shpjegimi i votës kundër, kur kërkohet nga anëtari, data e caktuar për mbledhjen e ardhshme dhe çështjet e rëna dakord paraprakisht.

d) Kur anëtari, për shkaqe që nuk varen nga ai, nuk mund të marrë pjesë në mbledhjen e

këshillit, lajmëron kryetarin ose zëvendëskryetarin. Përjashtim bëjnë vetëm anëtarët e agjencive statistikore, që njoftojnë, me shkrim, INSTAT-in. Ky njoftim ruhet dhe administrohet në dosje.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.130, datë 18.1.2007

PËR PROCEDURAT E RISHIKIMIT TË LISTAVE PARAPRAKE DHE SHPALLJA E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHËSVE “PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS 18 SHKURT 2007”

Në zbatim të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5194, datë 14.1.2007 “Për caktimin e datës 18 shkurt 2007 për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore”, të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr.9297, datë 21.10.2004, me ligjin nr.9341, datë 10.1.2005, ligjin nr.9371, datë 14.4.2005 dhe ligjin nr.9676, datë 13.1.2007,

UDHËZOJ:

1. Rishikimi i listës paraprake dhe miratimi i listës përfundimtare bëhet nga kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës, brenda datës 7.2.2007.
2. Kryetarët e bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë Tiranë, pasi kanë bërë miratimin dhe shpalljen e listës paraprake, jo më vonë se data 22 janar 2007, fillojnë procedurat e rishikimit dhe të ndryshimit në listat paraprake.
3. Listat paraprake ndryshohen në përputhje me nenin 57 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në rastet kur një zgjedhës:
 - a) vdes;
 - b) ka humbur të drejtën për të zgjedhur;
 - c) është regjistruar në më shumë se një listë;
 - ç) ka transferuar gjendjen civile;
 - d) provon se të dhënat e tij vetjake nuk janë të sakta;
 - dh) është regjistruar në qendrën e gabuar të votimit;
 - e) nuk është në listën paraprake të asnjë qendre votimi;
 - ë) nuk përmbush kriterin e moshës për të qenë zgjedhës në datën e zgjedhjeve;
 - f) nuk përmbush kriterin e shtetësisë.
4. Ndryshimet në listat e zgjedhësve bëhen me kërkesë të:
 - a) zgjedhësit, në mungesë të tij nga një pjesëtar i trungut të tij familjar;
 - b) Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;
 - c) ZGJC të njësisë përkatëse;
 - d) personave të tretë, për rastet e parashikuara në pikën 3, germa “a” dhe “b” të këtij udhëzimi.
5. Kërkesa për ndryshime në listën paraprake i paraqitet me shkrim kryetarit të bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës, jo më vonë se data 6 shkurt 2007 dhe përmban:
 - a) emrin e plotë të subjektit kërkues dhe adresën e tij;
 - b) shkakun për të cilin kërkohet ndryshimi në listë;
 - c) dokumente që provojnë shkakun për të cilin kërkohet ndryshimi në listë.
6. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, jo më vonë se data 6 shkurt 2007, u kërkon kryetarëve të bashkive, komunave, njësisë bashkiake për bashkinë e Tiranës, në regjistrin themeltar me vendbanim ku zgjedhësi ka regjistrime të mëparshme, ta heqë atë nga lista e zgjedhësve, për shkak të ndodhjes së tij në më shumë se një listë zgjedhësish.
7. Zyra e gjendjes civile jo, më vonë se data 6 shkurt 2007, i kërkon kryetarit të bashkisë,

komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës të bëjë ndryshimet në listën paraprake për rastet e përcaktuara në pikën 4, gjerat “a”, “ç”, “ë”, “f”.

8. Kërkesa dorëzohet në zyrën e protokollit të bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës merr masa për shpalljen në vende publike të vendit të depozitimit të kërkesave.

9. Zyra e protokollit pranon çdo kërkesë të bërë nga subjektet e përmendura në pikën 3 të këtij udhëzimi. Kërkesat e depozituara regjistrohen në një regjistër të veçantë. Numri i protokollit të kërkesës vendoset në vërtetimin që kjo zyrë i jep subjektit kërkuar. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës, merr masa që zyra e protokollit të funksionojë çdo ditë, gjatë periudhës së rishikimit, me orar të zgjatur, jo më herët se ora 19.00.

10. Kërkesat e depozituara i vihen menjëherë në dispozicion kryetarit, i cili, me përjashtim të rasteve kur kërkesa është bërë nga ZGJC dhe DPGJC, i kërkon menjëherë ZGJC-së, të verifikojë pretendimin e subjektit kërkuar. ZGJC bën shënimet përkatëse për vërtetësinë e informacionit, brenda ditës së bërjes së kërkesës.

11. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës vendos për kërkesën e bërë nga zgjedhësi brenda 24 orëve nga depozitimi i saj. Kërkesat e miratuara reflektohen menjëherë në listën përfundimtare.

12. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës njofton me shkrim zgjedhësin brenda 24 orëve nga marrja e vendimit.

13. Kopje të vendimeve të marra i dërgohen periodikisht Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, si dhe në përfundim të periudhës së rishikimit dhe një kopje ruhet në zyrën e protokollit për efekt arkivimi, së bashku me dokumentacionin përkatës.

14. Kundër vendimit të kryetarit të bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës, ose për mosmarrjen e vendimit brenda afatit, mund të bëhet ankim nga kërkuari në gjykatën e rrethit gjyqësor, ku ndodhet njësia e qeverisjes vendore, jo më vonë se 48 orë nga marrja e vendimit me shkrim për vendimin nga grupi i njoftimit, ose nga kalimi i afatit për marrjen e vendimit.

15. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës, është i detyruar të zbatojë vendimin e gjykatës dhe ta reflektojë atë në listën përfundimtare, brenda 24 orëve nga marrja e vendimit, por jo më vonë se data 7.2.2007, si në rastet kur paraqitet si palë në gjykim, ashtu edhe në rastet kur ai nuk paraqitet në gjykim.

16. Në rast se gjykata merr vendim pas kalimit të afatit të miratimit të listave përfundimtare, zgjedhësi është i detyruar të votojë sipas procedurës së parashikuar në nenin 60 të Kodit Zgjedhor.

17. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës miraton listat përfundimtare të zgjedhësve, duke pasqyruar:

- a) vendimet administrative të marra prej tij;
- b) vendimet e gjykatave për ndryshime në listat paraprake;
- c) evidentimet e kryera nga grupet e njoftimit dhe evidentimit të shtetasve të emigruar jashtë vendit, në përputhje me nenin 181/2 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 ”Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

18. Pas miratimit nga kryetari i bashkisë, komunës ose njësisë bashkiake për bashkinë e Tiranës, listat përfundimtare të zgjedhësve i dërgohen KZQV-së në datë 7.2.2007, të printuara në tre formate, sipas përcaktimeve të nenit 59 të Kodit Zgjedhor:

a) Listë zgjedhësish, e ndarë sipas qendrave të votimit për t’u shpallur pranë çdo qendre votimi. Kjo listë përmban në një kolonë të veçantë shënimin për shtetasit e evidentuar si emigrantë nga grupet e njoftimit dhe evidentimit. Një kopje e kësaj liste dhe në format elektronik i dërgohet DPGJC-së brenda 24 orësh.

b) Lista e zgjedhësve në nivel të njësisë së qeverisjes vendore që mbahet nga KZQV-ja për informimin e zgjedhësve. Kjo listë përmban në një kolonë të veçantë shënimin për shtetasit e evidentuar si emigrantë nga grupet e njoftimit dhe evidentimit.

c) Listë zgjedhësish, e ndarë sipas qendrave të votimit, e cila i dorëzohet KZQV-së për t’u përdorur nga KQV-ja ditën e votimit. Kjo listë duhet të përmbajë për çdo zgjedhës edhe emërtimin, numrin dhe faqen e regjistrimit themeltar me vendbanim të gjendjes civile të njësisë përkatëse.

19. Brenda 24 orëve nga marrja e listave përfundimtare, KZQV-ja i shpall ato pranë qendrave përkatëse të votimit në një vend me hyrje të lirë.

20. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës vë në dispozicion të

subjekteve zgjedhore kopje të listës paraprake dhe përfundimtare brenda 3 ditëve nga paraqitja e kërkesës.

21. Kryetari i bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Bashkinë e Tiranës, brenda 10 ditëve nga miratimi i listave paraprake dhe atyre përfundimtare të zgjedhësve, në përputhje me procedurat e nenit 56 të këtij Kodi, bën njoftimin me shkrim të zgjedhësit, sipas modelit të përgatitur nga DPGJC-ja, sipas kësaj procedure:

- Njoftimi i zgjedhësve kryhet nga grupet dyshe të punës të formuara nga një përfaqësues i administratës dhe një përfaqësues i caktuar nga partia me e madhe në opozitë me kryetarin e bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Tiranën.

- Brenda datës 20.1.2007 kryetari i kërkon partisë më të madhe opozitare në njësinë e tij të qeverisjes vendore të caktojë personat që do të marrin pjesë në grupet dyshe të punës për çdo qendër votimi. Brenda datës 22.1.2007, partia duhet të ketë dorëzuar listën e personave që marrin pjesë në grupet dyshe të punës.

- Kryetari cakton brenda datës 22.1.2007 grupet dyshe të punës për çdo qendër votimi. Njoftimi kryhet edhe vetëm nga përfaqësues të administratës së bashkisë, komunës, njësisë bashkiake për Tiranën, nëse partia politike nuk bie propozimet, kur ajo është e njoftuar me shkrim nga kryetari.

22. ZGJC vë në dispozicion të grupeve të punës, për njoftimin e zgjedhësve për çdo qendër votimi:

a) një kopje të listës paraprake me kolonën për evidentimin e shtetasve dhe hedhjen e firmës për familjet e kontaktuara;

b) njoftimet për çdo familje që ndodhet në listën e zgjedhësve.

23. Grupet e ngarkuara për njoftimin e zgjedhësve dorëzojnë njoftimin. Grupet e njoftimit kryejnë edhe evidentimin e shtetasve emigrantë në përputhje me udhëzimet e KQZ për këtë qëllim. Pas kryerjes së njoftimit dhe evidentimit të emigrantëve, një nga anëtarët madhorë të familjes firmos në listën e zgjedhësve të grupeve të njoftimit dhe evidentimit. Deklaratat e shtetasve të evidentuar si emigrantë dorëzohen në fillim të çdo dite për ditën paraardhëse. ZGJC, mbi bazën e deklaratave të dorëzuara, bën shënimet përkatëse në listën paraprake të zgjedhësve.

24. Për përgatitjen e listave përfundimtare të zgjedhësve, NJQV-të përdorin vetëm programin kompjuterik të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Sokol Olldashi



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

Datë: __/__/____

KERKESE

Unë i nënshkruari _____ i datëlindjes __/__/____,
(Emër, Atësi, Mbiemër)

pasi nuk kam marrë njoftimin për përfshirjen time në listën paraprake të zgjedhësve për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendpre datë **18 shkurt 2007** dhe pasi kontrollova listën e afishuar, konstatova se nuk figuroj në të.

Për arësyen e mësipërme, duke qënë se banoj në adresën e më poshtme:

Rruga _____

Ndertesa _____

Apartamenti _____

tel: _____

cel: _____

kerkoj regjistrimin tim ne listen e zgjedhesve, sipas të dhënave të çertifikatës/fotokopjes bashkëlidhur kerkeses.

Me respekt

Kerkuesi_____
(Emri, Mbiemri, Firma)**Plotësohet vetëm nga zyra e Gjendjes Civile** **Po**

Në bazë të të dhënave të Regjistrimit Themeltar, të dhënat e deklaruara janë të sakta.

 Jo

Në bazë të të dhënave të Regjistrimit Themeltar, të dhënat e deklaruara nuk janë të sakta, për arsye se: _____

Për Zyrën e Gjendjes Civile_____
(Emri, Mbiemri, Firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

VENDIM

Nr _____ date __/__/2007

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 58 të Ligjit 9087 datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 130 datë 18.01.2007 të Ministrit të Brendshëm "Për procedurat e rishikimit të listave paraprake dhe shpallja e listës përfundimtare të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 18 shkurt 2007", morra në shqyrtim kërkesën e shtetasit:

_____ i datëlindjes __/__/__,
(Emër, Atësi, Mbiemër)

për ndryshime ne listen paraprake te zgjedhesve me Nr _____ prot, date __/__/2007.

Bazuar ne verifikim e bere nga zyra e gjendjes civile :

Vendosa:**Të refuzoj kërkesën për shtetasin**

(emri atesia Mbiemri)

datelindja adresa shifrore zgjedhore

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

VENDIM

Nr _____ date __/__/2007

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 58 të Ligjit 9087 datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar dhe të Udhëzimit nr. 130 datë 18.01.2007 të Ministrit të Brendshëm "Për procedurat e rishikimit të listave paraprake dhe shpallja e listës përfundimtare të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 18 shkurt 2007", morra në shqyrtim kërkesën e shtetasit:

_____ i datëlindjes __/__/__,
(Emër, Atësi, Mbiemër)

për ndryshime ne listen paraprake të zgjedhësve me Nr _____ prot, date __/__/2007.

Bazuar ne verifikim e bere nga zyra e gjendjes civile :

Vendosa:

Të pranoj kërkesën e shtetasit për:

 Rregjistrim në listën e zgjedhësve të

(emri atesia Mbiemri) datelindja adresa shifrore zgjedhore

 Çrregjistrim nga lista e zgjedhësve të

(emri atesia Mbiemri) datelindja adresa shifrore zgjedhore

 Korrigjim në listën e zgjedhësve

(emri atesia Mbiemri) datelindja adresa shifrore zgjedhore

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia/Komuna _____

QARKU _____

VENDIM

Nr _____ date __/__/2007

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 58 të Ligjit 9087 datë 19.06.2003 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshur dhe të udhëzimit nr. 130 datë 18.01.2007 të Ministrit të Brendshëm "Për procedurat e rishikimit të listave paraprake dhe shpallja e listës përfundimtare të zgjedhësve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 18 shkurt 2007" pasi morra në shqyrtim kërkesën e shtetasit:

_____ i datëlindjes __/__/__,
(Emër, Atësi, Mbiemër)

për ndryshime ne listen paraprake te zgjedhesve me Nr _____ prot, date __/__/2007.

Bazuar ne verifikim e bere nga zyra e gjendjes civile :

Vendosa:**Të refuzoj kërkesën për shtetasin**

_____ (emri atësia Mbiemri)

_____ datelindja adresa shifrore zgjedhore

Kryetari

(Emri, Mbiemri, Firma)

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
 Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**
 1. PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)..... 1500
 2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) 600
 3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)..... 1300
 4. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT..... 500

Botime të reja

- 1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)..... 1000
- 4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)..... 500
- 5 PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË..... 1000
- 6 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR..... 800
- 7 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET..... 500
- 8 PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)..... 1000
- 9 PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE..... 500

Hyri në shtyp më 19.1.2007
 Doli nga shtypi më 19.1.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja Grafon
 Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë